



and have to be fulfilled regardless of the termination of this Agreement, including but not limited to obligations related to the academic activities, outstanding payments or compensations, tax reimbursement, etc., as may be applicable.

This Agreement is signed on _____, on _____, in 2 (two) original, equivalent copies, 2 (two) for each in Albanian, Spanish and English language. In case of any inconsistency, the English text shall prevail in interpretation.

For the Council of Ministers of the Republic
of Albania:

OGERTA MANASTIRLIU
MINISTER OF EDUCATION AND
SPORTS

For the National University of Distance
Education (UNED):

RICARDO MAIRAL USÓN
RECTOR

DEKRET
Nr. 280, datë 31.7.2024

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të
Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 86/2024, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Universitetit Kombëtar të Arsimit në Distançë (UNED) për hapjen e Universitetit Kombëtar të Arsimit në Distançë, kampusi në Gjirokastrë”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**
Bajram Begaj

AKT NORMATIV
Nr. 2, datë 1.8.2024

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË LIGJIN NR. 123/2014, “PËR
URDHRIN E MJEKËVE NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në ligjin nr. 123/2014, “Për Urdhrin e Mjekëve në Republikën e Shqipërisë”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në shkronjën “b”, të pikës 2, të nenit 4, fjala “... vendos ...” zëvendësohet me “... harton ...”.



Neni 2

Pas shkronjës “ç”, të pikës 2, të nenit 5, shtohet shkronja “d”, me këtë përmbajtje:

“d) nuk janë larguar me masën disiplinore të heqjes së licencës.”.

Neni 3

Shkronja “b”, e pikës 1, të nenit 7, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“b) kur i hiqet licenca individuale e ushtrimit të profesionit me vendim disiplinor apo me vendim gjykatë;”.

Neni 4

Pas shkronjës “c”, të nenit 8, shtohen shkronjat “ç” dhe “d”, me këtë përmbajtje:

“ç) të mos punojë në sistemin shëndetësor jopublik më shumë se 30 për qind të orëve mujore, që punon në sistemin shëndetësor publik;

d) të mos u kërkojë pacientëve, që i janë paraqitur në institucionin shëndetësor publik për trajtim dhe shërbime, në përputhje me specialitetin e tij, që t’i drejtohen institucionit shëndetësor jopublik, ku ai ushtron profesionin e tij.”.

Neni 5

Pas nenit 8 shtohet neni 8/a, me këtë përmbajtje:

“Neni 8/a

Kushtet dhe procedura që një mjek në një institucion shëndetësor publik mund të ushtrojë profesionin në një institucion shëndetësor jopublik

1. Një anëtar i Urdhrit të Mjekëve, që kërkon të ushtrojë profesionin e mjekut në një institucion shëndetësor jopublik, duhet t’i bëjë kërkesë titullarit të institucionit shëndetësor publik, ku ai është i punësuar.

2. Në kuptim të këtij ligji, termi “ushtrim i profesionit të mjekut” përfshin hapjen, pjesëmarrjen, si edhe punësimin në një institucion shëndetësor jopublik.

3. Anëtarët e Urdhrit të Mjekëve, të cilët janë punësuar në një institucion shëndetësor publik, që ka përfutur statusin e autonomisë spitalore

financiare, nuk mund të bëjnë kërkesë sipas pikës 1 të këtij neni.

4. Anëtarët e Urdhrit të Mjekëve, që mbajnë funksione drejtuese të çdo niveli në një institucion shëndetësor publik dhe në Universitetin Mjekësor Publik, nuk mund të mbajnë funksione drejtuese të çdo niveli në një institucion shëndetësor jopublik.

5. Titullari i institucionit vlerëson:

a) ngarkesën e orëve, që mjeku ushtron në institucionin shëndetësor publik;

b) mbulimin e shërbimit nga personeli tjetër mjekësor në institucionin shëndetësor publik;

c) mundësinë e konfliktit të interesit.

6. Në çdo rast, angazhimi i mjekut në institucionin shëndetësor jopublik nuk duhet të pengojë kryerjen e detyrës së tij/saj në institucionin shëndetësor publik, ose kjo veprimtari nuk duhet të kërkojë një angazhim mendor a fizik të tij/saj, që e bën të vështirë kryerjen e kësaj detyre, ose ushtrimi i kësaj detyre në institucionin shëndetësor jopublik mund të cenojë, në çfarëdo mënyre, imazhin e mjekut.

7. Në rast se titullari vlerëson se nuk plotësohen kërkesat e pikave 5 dhe 6, të këtij neni, vendos mosmiratimin e kërkesës. Në rast se titullari vlerëson se nuk ka pengesa për pranimin e kësaj kërkesë, miraton kërkesën dhe njofton ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë.

8. Ministria përgjegjëse për shëndetësinë bën publikimin e të dhënave të këtij mjeku në një regjistrë publik elektronik.

9. Procedura e verifikimit dhe e shqyrtimit të kërkesës, si dhe të dhënat, që do të bëhen publike në regjistrin elektronik, formati dhe mënyra e përditësimit të tij rregullohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për shëndetësinë.”.

Neni 6

Në pikën 3, të nenit 9, emërtesa “Inspektorati Shtetëror Shëndetësor” zëvendësohet me fjalët “Inspektorati përgjegjës për shëndetësinë ...”.

Neni 7

Shkronja “ç”, e pikës 1, të nenit 11, shfuqizohet.

Neni 8

Në shkronjën “dh”, të pikës 2, të nenit 13, pas fjalëve “... si dhe ...” shtohet fjala “... harton ...”.



Neni 9

Shkronja “c”, e pikës 2, të nenit 14, shfuqizohet.

Neni 10

Nenet 16, 17 e 18 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“Neni 16

Komisionet disiplinore

1. Procedimi disiplinor ushtrohet nga komisioni i disiplinës dhe komisioni i apelimit.

2. Komisioni i disiplinës funksionon pranë Urdhrit të Mjekëve dhe realizon shqyrtimin e ankesave, hetimin administrativ dhe, në rast konstatimi të shkeljeve, cakton me vendim masat disiplinore.

3. Vendimet e komisionit të disiplinës mund të ankimohen brenda 10 (dhjetë) ditëve nga njoftimi i arsyetuar në komisionin e apelit, që ngrihet pranë ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë.

4. Përbërja, organizimi dhe funksionimi i komisionit të disiplinës dhe të komisionit të apelimit rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 17

Masat disiplinore

1. Komisioni disiplinor heton e gjykon në bazë të fakteve dhe provave të administruara dhe të seancës dëgjimore me anëtarin e Urdhrit të Mjekëve, ndaj të cilit mund të merret masa disiplinore. Kur vërtetohet se anëtari ka kryer shkelje të etikës, të Kodit të Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore ose ka bërë gabime teknike, ai jep këto masa:

a) Vërejtje;

b) Pezullim për të realizuar shërbime të caktuara mjekësore, për një periudhë nga 6 (gjashtë) muaj deri në 3 (tre) vjet;

c) Pezullim të licencës së ushtrimit të profesionit të mjekut në tërësinë e saj, për një periudhë nga 6 (gjashtë) muaj deri në 5 (pesë) vjet;

ç) Gjobë me vlerë nga 100 000 (njëqind mijë) lekë deri në 1 000 000 (një milion) lekë;

d) Heqjen e licencës për ushtrimin e profesionit të mjekut.

2. Procedimi disiplinor fillon brenda 5 (pesë) vjetëve nga momenti i kryerjes së shkeljes. Në rastin

kur anëtari i Urdhrit të Mjekëve ushtron detyrën në të njëjtin institucion shëndetësor, ku ka kryer shkeljen disiplinore, procedimi disiplinor fillon menjëherë nga momenti i konstatimit të saj.

3. Masat disiplinore, sipas pikës 1, të këtij neni, shuhen:

a) për shkronjën “a”, 3 (tre) vjet pas dhënies apo përfundimit të saj;

b) për shkronjat “b”, “c” dhe “ç”, 5 (pesë) vjet pas përfundimit, përkatësisht, të periudhës së pezullimit apo të pagimit të gjobës.

Masa disiplinore, sipas shkronjës “d”, të pikës 1, të këtij neni, nuk shuhet.

4. Në caktimin e masave disiplinore, komisioni mban në konsideratë llojin e shkeljes, seriozitetin e saj, pasojat e ardhura, sjelljen e anëtarit të Urdhrit të Mjekëve ndaj këtyre pasojave, si edhe nëse ka pasur më parë shkelje të tjera disiplinore.

Neni 18

Ankimimi gjyqësor

1. Kundër vendimit të komisionit të apelimit lejohet ankimi në gjykatën administrative kompetente brenda 10 (dhjetë) ditëve nga marrja dijeni për vendimin.

2. Ankimi në gjykatë nuk pezullon zbatimin e vendimit të komisionit të apelimit.”

Neni 11

Pika 2, e nenit 19, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Këshilli Kombëtar harton Kodin e Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore dhe ia paraqet për miratim ministrit përgjegjës për shëndetësinë.”

Neni 12

Kudo në ligj fjala “... shtetëror ...” zëvendësohet me “... publik ...”, ndërsa fjala “... private ...” zëvendësohet me “... jopublik ...”.

Neni 13

Aktet nënligjore

1. Ministri përgjegjës për shëndetësinë nxjerr udhëzimin sipas pikës 6, të nenit 8/a, të ligjit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij akti normativ.



2. Këshilli i Ministrave miraton vendimet, sipas pikës 4, të nenit 16, të ligjit, brenda 3 (tre) muajve nga hyrja në fuqi e këtij akti normativ.

3. Urdhri i Mjekëve harton Kodin e ri të Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore, brenda 6 (gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij akti normativ. Deri në hyrjen në fuqi të Kodit të ri të Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore, mbetet në fuqi Kodi aktual i Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore.

Neni 14

Dispozita tranzitore

Anëtarët e Urdhrit të Mjekëve, që janë të punësuar në një institucion shëndetësor publik dhe që ushtrojnë profesionin e mjekut edhe në një institucion shëndetësor jopublik, detyrohen që, brenda dy muajve nga miratimi i udhëzimit të ministrit përgjegjës për shëndetësinë, sipas pikës 6, të nenit 8/a, të ligjit, të rregullojnë statusin e tyre, në përputhje me këtë akt normativ me fuqinë e ligjit.

Neni 15

Hyrja në fuqi

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

UDHËZIM

Nr. 5, datë 30.7.2024

PËR MËNYRËN E VLERËSIMIT TË GARANCIVE FINANCIARE TË LEJEVE MINERARE, PËR REHABILITIMIN E MJEDISIT

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës, të pikave 12 e 13, të nenit 31, të ligjit nr. 10 304, datë 15.7.2010, “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të pikave 1 dhe 3, të kreut I, të vendimit nr. 741, datë 9.9.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formës, rasteve të kthimit dhe mënyrës së llogaritjes së garancive financiare për rehabilitimin e mjedisit, për realizimin e Programit Minimal të Punës dhe realizimin e Investimit në veprimtarinë minerare”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH) për lejet e kërkim-zbulimit dhe Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) për lejet minerare të shfrytëzimit janë struktura përgjegjëse, të cilat gjatë procesit të vlerësimit të planit të rehabilitimit progresiv dhe përfundimtar të mjedisit, kryejnë vlerësimin dhe përlllogaritjen e vlerave të garancive financiare për lejet minerare, dhe i dërgojnë ato për miratim te ministri në përputhje me afatet e përcaktuara në ligjin nr. 10304, datë 15.7.2010, “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

2. SHGJSH-ja dhe AKBN-ja, për qëllime të zbatimit të parashikimeve të vendimit nr. 741, datë 9.9.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formës, rasteve të kthimit dhe mënyrës së llogaritjes së garancive financiare për rehabilitimin e mjedisit, për realizimin e Programit Minimal të Punës dhe realizimin e investimit në veprimtarinë minerare”, përgatitin projekt preventivat tip për mënyrën e llogaritjes së garancive të rehabilitimit për miratim nga ministri përgjegjës, të cilat përdoren për përcaktimin e vlerave të garancive të rehabilitimit, bazuar në kostot për realizimin e veprimtarive të mbylljes së punimeve gjeologjike të kërkim-zbulimit, të rehabilitimit progresiv e të rehabilitimit përfundimtar të mjedisit, të zonës së lejuar minerare dhe të asaj të përdorur nga subjekti për zhvillimin e veprimtarisë minerare.

3. Preventivat rishikohen me kërkesë të strukturave përgjegjëse (AKBN dhe SHGJSH), por të paktën çdo 2 (dy) vjet dhe miratohen nga ministri përgjegjës për veprimtarinë minerare.

4. SHGJSH-ja dhe AKBN-ja, në cilësinë e strukturave përgjegjëse, gjatë procesit të vlerësimit të planit të rehabilitimit përfundimtar dhe progresiv të mjedisit për lejet e kërkim-zbulimit, lejet e kërkim-zbulim-shfrytëzimit dhe për lejet e shfrytëzimit nëpërmjet këshillave teknike, përcaktojnë vlerën monetare të garancisë financiare të detyrueshme, të përgjithshme e vjetore, për realizimin e planit të rehabilitimit të mjedisit bazuar në preventivat tip sipas formatit në aneksin 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

5. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Shërbimi Gjeologjik Shqiptar për lejet e kërkimit, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore për lejet